



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2, datë 26.02.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës  
“Labëria”( Ora 10<sup>20</sup> )

Marrin pjesë:

- |                      |                     |
|----------------------|---------------------|
| 1.Rajmonda Zoto      | 22.Elca Bezhani     |
| 2.Vullnet Bilbilaj   | 23.Illir Aliaj      |
| 3.Edison Kapaj       | 24.Besmir Brahimi   |
| 4.Evis Allushi       | 25.Elpiniqi Mërkuri |
| 5.Endri Hyseni       | 26.Shkëlqim Leskaj  |
| 6.Sokol Kushta       | 27.Alta Haluci      |
| 7.Ledja Shollaj      | 28.Eglantina Aliaj  |
| 8.Liri Dëma          | 29.Grigor Dede      |
| 9.Dikens Bushaj      | 30.Brikena Sika     |
| 10.Frosina Qyrdeti   | 31.Klodian Xhyheri  |
| 11.Vjola Xhafaj      | 32.Ervis Moçka      |
| 12.Lorel Canaj       | 33.Atird Hoxha      |
| 13.Anxhela Shenaj    | 34.Geron Gunbardhi  |
| 14.Edlira Kapllanaj  | 35.Arsen Belaj      |
| 15.Simo Petromilo    | 36.Aurora Qarri     |
| 16.Roland Strakosha  | 37.Briseida Çakërri |
| 17.Novrus Rrokaj     | 38.Refie Laze       |
| 18.Marsela Dashi     | 39.Myzafer Elezi    |
| 19.Liljana Breshani  | 40.Gjergji Nika     |
| 20.Simbol Pazaj      | 41.Erëmal Arapi     |
| 21.Englantina Imeraj | 42.Gëzim Çapoj      |
|                      | 43.Bujar Osmënaj    |

Mungojnë :

- 1.Brikena Puka
- 2.Ardian Musta
- 3.Eneida Vera
- 4.Anisa Ceno
- 5.Jerina Dervishaj
- 6.Mujo Shakaj
- 7.Eda Begaj
- 8.Arjan Isufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 2/1, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes të gjithëve!

Meqenëse kuorumi është realizuar, fillojmë mbledhjen e këshillit.

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 29.01.2024.

E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Vijojmë me shprehjen e ligjshmërisë, ardhur nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për vendimet e këshillit Nr 1- 8, janë vlerësuar të ligjshëm . (lexon shkresën e ardhur nga P.Q.Vlorë) Përpara se të miratojmë rendin e ditës, sot na ka ardhur një projektvendim, për ta futur në rendin e ditës , “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Albanian – American Development Foundation dhe Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Vlorë, “Për ngritjen e Muzeut Hebraik të Shqiptarëve, në Vlorë “.

Nëse, kryetarët e grupeve duan ta shikojnë dhe më vonë vendosim. Projektvendimi është për ngritjen e Muzeut Hebraik në Vlorë.

Ta hedhim në votim për ta shtuar në rendin e ditës. Votohet

Të gjithë pro- 38.

Nëqoftëse , s’keni gjë në lidhje me rendin e ditës, e hedhim në votim.

Votohet.

Pro – 38 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet rendi i ditës.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/2, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin janar 2024” .

Z.Endri Hyseni – U diskutua ky projektvendim në mbledhjen e komisionit tonë. Tek baza ligjore e lamë të shtohet VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “ dhe VKB Nr 1 , datë 29.01.2024 “Për miratimin e kriterëve për përfitim të ndihmës ekonomike” si, dhe lista emërore , duhet të jetë pjesë integrale me projektvendimin , pra një trup.

Pra, me këto dy ndryshime , mendojmë ta kalojmë për miratim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E hedhim në votim, me ndryshimet e propozuara., nëqoftëse nuk ka pyetje dhe diskutime.

Votohet.

Pro – 38 vota

Kundër - 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/3, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin janar 2024”. Një relacion

Z.Endri Hyseni – I vetmi ndryshim në bazën ligjore, është të shtohet dhe VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vlorë, për vitin 2024 “ dhe lista emërore një trup me projektvendimin .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse, nuk ka ndonjë pyetje, diskutim ,e kalojmë për miratim.  
Votohet .

Pro – 38 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/4, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës, me miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 12 mujore me të ardhurat e bashkisë”. Më parë një relacion nga komisioni përkatës .

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim, u trajtua në komisionin tonë. Bëhet fjalë për fëmijë të familjeve me probleme të thella social ekonomike.

Sipas pikës 5, ...lexon, ky vendim hyn në fuqi siaps ligjit nr 139/2015, neni 55, pika 6 . Ky është i vetmi ndryshim, në pikën 5.

Znj.Irena Stasa – Është i 7 vit, që paraqesim këtë projektvendim , duke u nisur nga problemet e thella social ekonomike të këtyre familjeve. Janë dhe familje një prindërore, vajza - nëna., nëna me urdhër mbrojtje...Nisur nga këto problematika dhe verifikimeve nga administratoret , janë hartuar këto lista.

Z.Atird Hoxha – Nuk kemi gjë kundër këtij projektvendimi. Është i paqartë, mënyra si janë zgjedhur..A janë vetëm këta fëmijë ? Në këto kushte, është i paplotë .

Informimi i qytetarëve ...A është në një shkallë të gjerë informimi, pra që mund ta përfitojnë dhe familje të tjera që kanë kushte të tilla. Pra, mendoj që , bashkia , duhet të bëjë fushatë sensibilizimi...11 fëmijë për kopshte dhe 9 fëmijë për çerdhe...Nuk mendoj se, janë vetëm këta.

Znj.Irena Stasa - Ky program.., janë të selektuar vetëm për familjet me skemë të ndihmës ekonomike . Bëhet selektimi sipas rasteve dhe grupmoshave. Administratoret sociale, kanë bërë një fushatë të gjerë sensibilizimi. Janë vajza nëna, është 1 rast dhe është trajtuar, është me 3 fëmijë.

Është një grup pune që punon dhe trajton këto familje. E them me përgjegjësi të plotë. Flas teknikisht, janë parë familjet që kanë vërtet nevojë.

Z.Illir Aliaj – Një pyetje kisha. Të më japë një sqarim.... Pra, Bashkia Vlorë , ka një fond limit, e ka të përcaktuar apo zgjidhen familjet si fillim dhe, më pas caktohet fondi ?

Së dyti, pjesa e infrastrukturës, është përcaktuar 11 me 9, apo ka vende të tjera ? Pra, është ana financiare dhe infrastruktura. Ne mund të shtojmë apo të heqim ndonjë kriter .

Znj.Irena Stasa – Fondi limit është, fond për probleme të ndryshme. Kam nevojë për buxhet shtesë , kanë nevojë, ka dhe shoqëri informuese..., Ka një pjesë të limitit dhe për infrastrukturën, në bashkëpunim kjo dhe me Drejtorinë Arsimore. Për çerdhet, duhet numër më i madh.

Kur ka nevojë dhe ratse të tjerë, i kalojmë në vazhdimësi. Deri tani këto ishin kërkesat. Nuk janë për gjithë qytetarët e tjerë, vetëm për familjet në skemën e ndihmës ekonomike

Znj.Edlira Kapllanaj – Ky projekt ka 7 vjet që implementohet. Kemi shtuar dhe dy fëmijë të komunitetit rom. Të ketë një fushatë sensibilizimi dhe të bashkëpunohet me këshilltarët dhe drejtorinë e ndihmës ekonomike. Duhet shtrirë në gjithë rajonet.

Z.Myzafer Elezi – Shikoj listën, numrat 5,6,7, kanë të njëjtën atësi ..., datëlindjet ...A është ndonjë lapsus?

Znj. Irena Stasa – Lapsus është..., janë nga e njëjta nënë. Do ta rregullojmë tek zbardhja e vendimit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E kalojmë në votim.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/5, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës, me miratimin e projektvendimit “ Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

Znj.Elca Bezhani – Lidhur me këtë projektvendim, me pikën 4 të rendit të ditës, në komisionin e ekonomisë, sektori i strehimit ,pra administrata, paraqiti relacionin me argumenta, bazuar në kriteret, për përfitimin e këtij bonusi. Vetëm të shtohet VKB Nr 100, datë 29.12.2023, “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024”.

Në relacionin teknik u theksua se, për këto familje, komisioni i strehimit, kishte marrë në trajtim gjithë dokumentacionin. E njëjta gjë,sikurse u tha, nëse familjet që kanë nevojë për subvencion...pra, duhet bërë një sensibilizim më i madh në lidhje me përfitimin e këtij subvencioni. Mendoj ta kalojmë për miratim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E kalojmë në votim.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/6, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 5, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për, “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Z.Endri Hyseni – Ky projektvendim, i sjellë nga drejtoria e infrastrukturës, vërehet një mbështetje sociale që u jepet qytetarëve në nevojë...Ky projektvendim, është pjesë e procedurës. .

Vlen për tu përgëzuar puna e kësaj drejtorie, për aplikimin dhe përfitimit për bashkëfinancim.

Z.Klodian Xhyheri – Tabela 2..

Znj.Elca Bezhani – Pika 5 , është miratimi i deklaratës dhe pika 6 miratimi i listës për familjet...Është e njëjta gjë.

Z.Klodian Xhyheri – Është pika 6.

Znj.Elca Bezhani – Të dy këto projektvendime, janë të njëjtë.

Z.Klodian Xhyheri – Pse fshati Drithas dhe, jo një fshat tjetër?

Znj.Elca Bezhani – Është më emergjent.

Z.Klodian Xhyheri – A është zonë informale kjo ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – A mbarojmë projektvendimin , pikën 5 ?

Kush është pro ?

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/7, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Z.Klodian Xhyheri – U sqarova.

Znj.Edlira Kapllanaj – Po të shihet lista, sigurisht që nuk janë 6 familje me probleme, por ka një ngërç për plotësimin e kriterëve, pra mungon çertifikata e pronësisë.

Dua një data base, sa familje kanë përfituar dhe sa ka qenë fondi. Dua që ky projekt të shkojë tek ato shtëpi që vërtet e përfitojnë. Dua një informacion herën tjetër, pra listën dhe fondin. Dua ta monitoroj.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Atëherë, bëni një kërkesë dhe depozitoheni për t’ia nisur drejtorisë.

Z.Atird Hoxha – Në pikën 2 të kësaj liste...fshati Drithas, është zonë informale ...Në këtë drejtim , administrata ose gënjen ose ... Thoni që janë 250 familje...Pse keni listuar 50 familje? Janë emrat e kryetarit të njësisë administrative, nipi i tij ..etj..Pse duhet ta kenë emrin (lexon)Pse janë listuar këta dhe jo 56 të tjerë...Ke tabelat...Çfarë përfitojnë këta të listës? Ose të vihen 250, ose të hiqen 56., ose në përgjithësi për fshatin.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mos bërtisni..Pse ngrini zërin ? Ju dëgjojmë.

Z.Zambak Selmani – Nuk ka të bëjë as me 56 dhe as me 250. S’ka lidhje me familjet. Bëhet fjalë për rregullimin e rrugës së fshatit Drithas. Është parashikuar në buxhet. Ne kërkojmë bashkëfinancim. Nuk ka lidhje me emrat.

Z.Atird Hoxha - Pse duhet të listohen këta emra...hiq dhe përfituesit .., hiq edhe 250.

Z.Zambak Selmani - Nuk mund të vendosim një rrugë tjetër. Nuk kanë lidhje emrat. E kërkon projekti.

Z.Atird Hoxha – Nuk jemi kundër aplikimit.., ose hiqini këta , ose vendosni gjithë fshatin.

Z.Ervis Moçka – Po bëhet diskutim i gjatë. Në momentin që, këta s’janë përfitues individualë...Pra, është parashikuar në buxhet, për rrugën ministria do financojë dhe janë të gjithë përfitues.

Nëqoftëse, duhet një bazë ligjore për 50 emra të tjerë ,.. apo listë ..., rruga është për të gjithë komunitetin.

Z.Atird Hoxha – Jam dakort me zotin Moçka .

Z.Illir Aliaj – Nëqoftëse, do hiqet kjo pikë, me ç'të drejtë, do ti kërkojmë fonde ministrisë...Në buxhetin e bashkisë për vitin 2024 , u miratua dhe fondi për rrugën e fshatit Drithas , por për të shtuar fondin , për të bërë punë më të mirë dhe cilësore...Për të rritur fondin limit nga 66 ..në 120.. Pra, duhet që dhe familjet në proces legalizimi , duhet të jenë të pasqyruara në listën emërore. Ligji i mbështet. Të 250 shtëpitë , përfitojnë nga ky lloj investimi, ku do përfshihen këtu dhe kanalizimet etj, pra përmirësim në infrastrukturë. Mendoj ta kalojmë për miratim këtë projektvendim.

Z.Klodian Xhyheri – Projektvendimi, ka një non sens..., citon pikën 2 ... Atëherë, vendosni 250 familjet ..., ose hiqni listën.

Znj.Elca Bezhani – Ne me diskutimet tona, po bëhemi pengesë për çështje proceduriale .

1. Në listën e emrave, që përfitojnë 6 familje,në krah kemi dhe nivelin e të ardhurave mesatare mujore dhe,

2. Në listën e dytë me 50 emra, anëtarë të fshatit Drithas, por pa të ardhurat mujore.

Pra, kemi dy lista, këtë doja të qartësoja.

Z.Ervis Moçka – Nuk e di si është bërë kjo përzgjedhje. Drejtoria të bëjë dhe një përzgjedhje të shtojë plus 50 –es dhe 30 e ca , të thirret administratori dhe ta përfitojnë të gjithë banorët. E rëndësishme, është që fondi të shkojë në fshatin Drithas.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pra, e votojmë me propozimin e zotit Moçka , pra me shtesën e 30 familjeve Votohet.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/8, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për krijimin e Shoqërisë “Markata e peshkut –Vlorë” SH.A, si person juridik , në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe miratimit të Statutit “.

Një relacion nga komisionet dhe vazhdon administrata ..

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim u diskutua në komisionin tonë dhe, vendosëm ta sjellim në mbledhjen e këshillit. Jemi njohur , është dhe statuti . Materiali është i plotë. Të krijohet shoqëria “Markata e peshkut”, ku do të përmirësohet shërbimi dhe do japë zhvillim ekonomik.

Z.Atird Hoxha – E dëgjova kryetarin e komisionit. Krijimi i kësaj shoqërie, nuk ka asgjë të keqe. Bëhet fjalë për triportin, për këtë zonë, ku ka ekonomi familjare të vogla.....,ku do kalojë 100% në pronësi të Bashkisë Vlorë . E para, që nuk është e konsultuar me ata të peshkimit, ndikon dhe në turizëm.

Në këtë format dhe këtë projektvendim do hasim një pengesë totale të atyre njerëzve atje. Godina do merret në administrim nga bashkia dhe ata të sektoit të peshkimit do detyrohen të futen në marrëveshje me bashkinë , për shitjen.

Jam dakort, por në relacion është totalisht shtetëzim. Ky është një treg që vetë rregullohet. Për këtë, mendoj që, ky projektvendim nuk duhet ta marrë miratimin e këtij këshilli. Sot do ta administrojë bashkia...Relacioni është absurd..

Znj.Briseida Çakëri – Nuk jemi në kohën e “ adam smith”...Kjo markatë duhet krijuar.

Z.Geron Gunbardhi – S’jam dakort dhe me disa pika të Atirdit. Është një fond nga Bashkimi Europian 2,5 milion Euro...I vetmi merak , është që të jenë të rregulluara mardhëniet me qytetarin dhe bashkinë dhe jo ti jepet ndonjë oligarku si Gjergj Luca . Është shumë gjë europiane , të bëhet, por duhet dhe një takim me këtë komunitet.

Z.Grigor Dede – Zoti Atird, më mirë të merrej me çështje teknike , sikurse Statutin, meqenëse është jurist.

Me këtë merkat, do të jetë dhe do të ketë një veprimtari me kushte më të mira, do t’ju shërbejë peshkatarëve.

Duhet ta mbështesim fuqishëm këtë projektvendim ..Lidhur me Statutin..., që projektvendimi të jetë sa më efikas ..., jam plotësisht dakort..., kjo markatë do krijojë shumë lehtësira , do kenë dhoma frigoriferike, ambiente tregëtimi...Kjo ofron vetëm të mira dhe jo vështirësira.

Z.Gjergji Nika – Krijimi i shoqërisë Sh.A, është mëse normale. Duhet që çmimet të dakortësohen. Pika 12..lexon...., tek zmadhimi i kapitalit ...Atëherë, nëqoftëse, dikush sjell një ofertë për të blerë këto aksione..dhe nëqoftëse është dakortësuar ....bashkia refuzon dhe bëhet .....

Pra, tek pjesa e zmadhimit të kapitalit , të jetë më e sqaruar, më e qartë në projektvendim që, për “x” vit, bashkia nuk pret oferta .

Z.Ervis Moçka – Është i drejtë si shqetësim, po do jetë po ky këshill si mekanizëm frenimi , Asambleja e përgjithëshme..

Pra, vetëm .... Pra, duhet vetëm vendimi i këshillit ..Pra, nëqoftëse do zmadhohet kapitali , vetëm po nga këshilli dhe më pas të shihet ligji,,normat e tregut për shoqëritë tregëtare.

Z.Endri Hyseni – Markata nuk ka lidhje me çmimin e peshkut. Nuk e cënon tregëtinë dhe tregun e lirë . Në kohën që jetojmë , e vetmja gjë që ndikon , është rregullimi i gjithë shërbimit për qytetarët sipas kushteve higjieno – sanitare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E kalojmë në votim.

Pro – 35 vota

Kundër – 6 vota

Abstenim – 1 votë.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/9, datë 26.02.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e dakortësisë në vijimin e procedurave , të heqjes së fondit kullësor publik(për sipërfaqen prej 0,97 ha, në ekonominë kullësore Shashicë-Gumenicë, ngastrat nr 14 dhe 15), aktiviteti i prodhimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror(karierë), nga Shoqëria “VAMEL”Sh.p.k . Komisioni përkatës apo drejtori përkatës, një relacion.

Z.Illir Nika – Sipërfaqja 0,97 ha, në ekonominë kullësore Shashicë – Gumenicë , shoqëria, i është drejtuar Ministrisë së Turizmit . Kjo sipërfaqe është pronë e Bashkisë Vlorë. Ne mbas Urdhërit të Kryetarit, bëjmë relacionin tekniko – ekonomik. Kjo shoqëri zhvillon aktivitet në Bashkinë Selenicë dhe, kërkon të kalojë dhe në pjesë të Bashkisë Vlorë, duke filluar nga Vodica. Në rastin konkret , kemi punësuar 11 punonjës, krijimin e dy leraVe.Raporti është 1 me 2 ha, në Pyllin e Sodës të bëhet pyllëzimi i 2 ha.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të na sqarojë inxhinieri. Zona çfarë përfitimi do ketë ?

Z.Illir Nika – Punësimi i 11 punonjësve, hapja e rrugës 1,4km ..tarifa e rrugës që është 53 mijë lekë/reja , e paguan firma...është një detyrim ligjor dhe bashkëlidhet me ...Bëhet një kontratë , të gjitha do ti bashkëlidhim.

Z.Gjergji Nika – Çfarë do të thotë pyllëzim ?

-A është bërë analizë nga kompania ...A do ta vazhdojë aktivitetin ..

Z.Illir Nika –Kanë vite që paguajnë taksën . Kërkojnë të zgjerohen, është në kufi.

Për pyllëzimin i’a kërkojmë ne 7000ha kullësor. Të ecim me planin e menaxhimit, brenda kuadrit ligjor.

Z.Simo Petromilo – Ky projektvendim u diskutua në komisionin e bujqësisë. U bënë shumë pyetje dhe diskutime dhe, u lanë rekomandime. Kjo të kompensohet në vlerë, për bërjen, hapjen e dy leraVe, ku punon kompania . Mbetjet që dalin nga aktiviteti, dëmtojnë kullotën. U diskutuan në komision. Në parim jam për ta kaluar , por ti lihen detyra kompanisë.

Z.Besmir Brahimi - Disa përmirësime..Lexon relacionin (bashkëlidhur relacioni i plotë, baza

ligjore )...Neni 19 ...pjesë jo pyjore..d.m.th gjithë shqyrtimi ... të jepet me qira, plus disa detyra firmës. Rruga, është dhe në ligj, e ka taksative ta bëjë...Pyllëzimi, duhet ta mbrojmë.

Ta heqim nga fondi kullosor dhe ta japim me qira . Jam për ta dhënë me qira.

Z.Vullnet Bilbilaj – Isha prezent në mbledhjen e komisionit ...Lexon..pra, saktësohen ngastrat . Mbasi dëgjuam shpjegimin nga administrata , të gjithë ramë dakort, duhet bërë dhënia e dakortësisë me disa propozime shtesë.....ME...ne na duhet thjesht të japim dakortësinë. Me propozimet e bëra nga ne , në lidhje me benefitet e komunitetit, si punësimi i 11 punonjësve, rruga..., janë bërë dëgjesa publike në lidhje me këto ngastra, nr 14 dhe 15. Jam i mendimit ta kalojmë .

Z.Simbol Pazaj – Dy pyetje kam për përfaqësuesin e kompanisë.

Sa vjet ka që ushtrohet ky aktivitet ?

Z.Inxhinier/Përfaqësuesi i kompanisë – 3 vjet.

Z.Simbol Pazaj – Jam i mendimit të shtyhet për mbledhjen tjetër , që të na vijë relacion nga Bashkia Selenicë, a kanë kryer pyllëzim, atje ku ushtron këtë aktivitet ?

Z.Illir Aliaj – Kemi diskutuar për mbarështim të pyjeve. Zoti Ilir, do të pyesja këtë parcelë që e kaluam , tani mos bëjmë ndonjë gabim, mos është dhe po punohet në këtë parcelë ?

-Të japësh një karrierë, kjo është diçka shumë pozitive. Por, duhet parë dhe në aspektin mjedisor. Unë e shikoj në aspektin mjedisor, meqenëse Bashkia Selenicë e ka pas më të lehtë për ta dhënë , fshatrat janë në distancë të largët , kurse për pjesën e Kaninës ...A është marrë ndonjë informacion, në lidhje me mjedisin , ujin e pijshëm...E ka bërë relacionin të përgjithshëm, inxhinieri. Jam pak i dyzuar.

Z.InxhinierPërfaqësuesi i firmës – Kemi leje të shfrytëzimi të mineraleve dhe leje mjedisi. I kemi të gjitha brenda kushteve tekniko – ekonomike. Jemi mbi 10 km larg nga zonat e banuara.

Z.Illir Nika – Në lidhje me pyllëzimin, jemi lidhur me ministrinë ...Pjesa e ankandit Ministria,.. jepet 1ha me 2 ha pyllëzim. Janë tarifa me akt marrëveshje, janë taksative . Me ministrinë kanë tarifa fiske. Janë të parashikuara në ligj. Do të miratohet apo jo, është e drejta juaj.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Sa janë pro ?

Votohet

Pro – 32 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 7 vota

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/10, datë 26.02.2024

Znj.Elpiqi Mërkuri - Vazhdojmë me projektvendimin shtesë “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Albanian – American Development Foundation dhe Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Vlorë, “Për ngritjen e Muzeut Hebraik të Shqiptarëve, në Vlorë “.

E kalojmë në votim ... Pro ...

Z.Besmir Brahimi – E vlerësoj, e miratoj ngritjen e këtij muzeumi , por në lidhje me varrezat, në vitin 1945 , genocidin çam ..Ne respektojmë hebrejtë, veten tonë, jo.

Znj.Elpiqi Mërkuri – Është dhe në vazhdën e historisë dhe miqësisë, së popullit vlonjat dhe komunitetit hebre.

Votohet

Pro – 41 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 2/11, datë 26.02.2024

Znj. Alta Haluci – Sa e vërtetë është idea e mbylljes së shkollës “Tregëtare “ dhe të kalimit në korpus në shkollën “Industriale “, shkolla më e vjetër .

Është emër për Vlorën. Sivjet kjo shkollë ka dhe 100 vjetorin, ka nxjerrë kaq shumë nxënës dhe studentë...Ka një superbibliotekë, që as, biblioteka e aytetit, nuk e ka.

Shkolla Tregëtare është një vend që duhet të krenohemi, të qëndrojmë ajo shkollë. Apo i është vënë syri si universitetit.

E nderuar kryetare ! Dua nga Ju një përgjigje. Është një shkollë 100 vjeçare. Do ta ngre zërin në çdo mbledhje, se bëhet fjalë për një shkollë 100-vjeçare.

Ne si vlonjat, të ngremë zërin, është e të gjithëve.

Mos e bëni si universitetin, si qendrën e qytetit, Sheshin e Flamurit etj..Keni ndonjë përgjigje ?

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Në e-mail, ju ka ardhur një amterial nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile. E keni parë ?

Znj. Alta Haluci – Ja keni vënë syrin, mund të ktheni përgjigje zonja kryetare ?

Znj. Elpiniqi Mërkuri – S’kam ndonjë përgjigje.

Znj. Alta Haluci – Ktheni përgjigje zonja kryetare. Jeni apo s’jeni pro, heqjes së shkollës “Tregëtare”

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Mos e bëni politike këtë çështje.

Z. Ervis Moçka – Lidhur me shqetësimin Tuaj , zonja Alta, zonja është kryetare e këshillit , ka besimin e grupit. Për shqetësimin Tuaj, nuk e di. U diskutua për përmirësime të shkollave profesionale, ka pas diskutime, por nuk është marrë një vendim i tillë. Jam pjesë e bordit të kësaj shkolle dhe nuk u diskutua për tjetër gjë. Bordi diskutoi për 100 vjetorin , përmirësimin e arsimit, por jo vendim. Nuk ka asnjë plan apo ide, që të jemi në dijeni.

Do bëjmë thirrje dhe me komunitetin.

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Lidhur me informacionin e ardhur në e-mail, për emergjencat civile.

Z. Daut Zëraj – Këtë herë ishte informacioni për emergjencat civile, herën tjetër për realizimin e investimeve , nga drejtoria e infrastrukturës. Nëqoftëse, keni diçka ? E kemi në planin e punës.

Z. Myzafer Elezi – Kam një shqetësim . Aksi rrugor Kaninë, nuk ka asnjë kryqëzim...

Pak më poshtë, është një segment rreth 70 m, për tu bërë, për tu përmirësuar ky aks rrugor.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka ndonjë gjë tjetër në lidhje me pikën “Të ndryshme “.

-Jo.

Faleminderit për mbledhjen e sotme.